REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 933/20
Datë/Datum. 30.11.20
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Emri dhe Mbiemri i eks. Shqyrtues dhe nënshkrimi	*Data e autorizimit të ekspertit*	*Data e dorëzimit të Raportit*	*Nr. i lëndës:*
	18.11.2020	30 .11.2020	933/20

NENI 105 i LPP-së, BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën:13.11.2020, OE "ART-DEA SH.P.K & LONI" SH.P.K -Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr: 933/20, kundër njoftimit për anulim, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Rehabilitimi, riparimi dhe mirëmbajtja e kanalit, akuadukteve dhe strukturave në hidrosistem", me nr te prok: IL-20-4496-5-1-1, të iniciuar nga AK – "N.H IBËR LEPENC" SH.A.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, punë, vlera e parashikuar e kontratës: 880, 000.00 €.

Data e njoftimit për kontratë.....18.08.2019.
Data e korrigjimit të njoftimit për kontratë.....21.08.2020.
Data e korrigjimit të njoftimit për kontratë.....03.09.2020.
Data e korrigjimit të njoftimit për kontratë.....25.09.2020.
Data e hapjes së ofertës.....09.10.2020.
Data e njoftimit mbi vendimin e AK-së.....29.10.2020.
Data e njoftimit të ofertuesve të papërgjegjshëm.....29.10.2020.
Data e kërkesës për rishqyrtim.....03.11.2020.
Data e vendimit të AK-së lidhur me kërkesën për rishqyrtim:.....06.11.2020.

Nuk është e përsëritur ankesa.

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068,

dhe Ligjin 05/ L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

PRETENDIMET ANKIMORE DHE DISPOZITAT E SHKELURA "ART-DEA SH.P.K & LONI" SH.P.K – Prishtinë.

Dispozitat e shkelura sipas OE ankues "ART-DEA SH.P.K & LONI" SH.P.K -Prishtinë, janë:

Neni 7 – Barazia në trajtim / jo Diskriminimi;
Neni 56 – Dispozitat e Përgjithshme mbi Përzgjedhjen e Pjesëmarrësve dhe Dhënien e Kontratave;
Neni 59 – Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve;
Neni 60 – Kriteret për Dhënien e Kontratës;
Neni 65 – Pranueshmëria e Kandidatëve ose Tenderuesve;
Neni 69 – Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale;
Neni 41 – RRUOPP-së;

DEKLARATA DETALE MBI FAKTET DHE ARGUMENTET:

Me datë: 21.10.2020 kemi pranuar letrën standarde për tenderuesin e eleminuar. Me datë 22.10.2020 ne kemi kërkuar qasje e dokumentacionin tenderit të OE të propozuar për dhënie. Qasja na është mundësuar po të njëjtën ditë: 22.10.2020 në ora 14:00. Në qasje ne kemi kërkuar qe te na jepet kopje e materialit të OE të propozuar për dhënie të kontratës, OE tjerë pjesmarrës në këtë procedur si dhe raporti i vlersimit nga ana e komisionit.
Me datë: 26.10.2020 një nga OE pjesëmarrës ka bërë ankes për rishqyrtim pran AK dhe AK me datë 29.10.2020 ka dhënë përgjigje për rishqyrtim dhe pas rivlerësimit anulon aktivitetin e prokurimit me arsyen se asnjë kompani pjesëmarrëse në këtë aktivitet nuk është i përgjegjshëm, në këtë rast AK - Komisoni i rivleresimit ka bërë shkelje te dispozitave të LPP-se duke na eleminuar padrejtesisht nga gara sepse arsyeja e eleminimit tonë është e pa baze, ku kërkesa në FDT ka qenë që: *Operatori Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të natyrës së ngjashme për punë dhe mirembajtje, në tri vitet e fundit nga data e publikimit të Njoftimit për Kontratë, në vlerë min. 1,300,000.00 €uro.*
Pas vendimit te AK me datë 03.11.2020 ne si OE pas marrjes se vendimit te AK kemi parashtruar kerkese per rishqyrtim kunder anulimit te AP.
Me datë 06.11.2020 kemi pranuar vendimin e AK mbi refuzimin e kerkeses sone per rishqyrtim duke na eleminuar padrejtesisht nga AP si dhe ka bere anulimin e ketij aktiviteti.

Ne FDT 9.1 & 9.2 është kërkuar:

Operatori Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të natyrës së ngjashme për punë dhe mirëmbajtje, në tri vitet e fundit nga data e publikimit të Njoftimit për Kontratë, në vlerë min. 1,300,000.00 €uro.

Ndërsa si dëshmi:

Lista e projekteve te kryera në lëmin e punëve të ngjashme të realizuar në tri vitet e fundit, nga data e publikimit të Njoftimit për Kontratë, duke saktësuar Titujt e projekteve, shumën e kontratës, numrin e Prokurimit, data e kontraktimit – duhet të dorëzohet në origjinal, i nënshkruar dhe i vulosur nga Operatori Ekonomik, DHE dëshmitë e përfundimit, Referencat ose Pranimit teknik për punë të kryera në lëmin e punëve të ngjashme.

Arsyeja e eliminimit se ne nuk e kemi ofruar referenca në vlerë prej 1,300.00.00 euro në lëminë e ndërtimit dhe mirëmbajtjes është e pa bazuar sepse ne në total kemi ofruar kontrata dhe referenca në vlerë prej 3,379,984.11 € , mirëpo që ju nuk i keni marr parasysh këto dëshmi.

Sa i përket referimit tuaj në arsyen e eliminimit përkitazi me referencat në lëminë e ndërtimit, ju sqarojmë se kërkesë në nenin 9.1&9.2 e FDT-së ka qenë që të ofrohen dëshmi se janë përfunduar me sukses kontrata të natyrës së ngjashme për punë dhe mirëmbajtje. Ndërsa tek dëshmia e kërkuar dokumentare keni kërkuar listën projekteve të kryera në lëminë e punëve të ngjashme të realizuara në tri vitet e fundit.

Pra kur merret parasysh kërkesa dhe sqarohet në detaje kuptohet që ju keni kërkuar kontrata të natyrës së ngjashme për punë dhe mirëmbajtje – specifikacioni në bazë të paramases nenkupton qe kjo pune eshte 100% ndertim i ulet, prandaj qdo referencë dhe kontratë që ofrohet si dëshmi e që përmban punë dhe mirembajtje duhet të merret parasysh dhe si e vlefshme. Termi punë dhe shërbime të ngjashme është term shumë i zgjeruar dhe duhet të pranohen dëshmitë në këtë rast për çdo punë e cila lidhet me këtë projekt dhe e cila është e përafërt. Dihet që në kuadër të punëve hyjnë ndërtimi i lartë, ndërtimi i ulët, asfaltimi, ndërtimi i memorialëve, kanalizimi etj. Po ashtu edhe dëshmitë që ofrohen të ngjashme me mirëmbajtje duhet të merren parasysh dhe si të vlefshme, pasi që në këtë dosje të tenderit nuk është kërkuar që të ofrohen dëshmi për punë të njëjta apo shërbime të njëjta.

Duke u bazuar në këtë sqarim rezulton se ne e kemi plotësuar kërkesën e lartcekur, madje e kemi tejkaluar vlerën e kërkuar shumëfish. Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura kuptohet që ju na keni eliminuar neve në kundërshtim me nenin 56.3 të LPP-së sepse na keni eliminuar për një kërkesë e cila nuk ka qenë e specifikuar në FDT dhe tek njoftimit për kontratë, kurse neni 56.3 i LPP-së e parasheh qartë "Tenderuesi, gjatë procedurave të hapura, ose kandidati, gjatë procedurave të kufizuara dhe procedurave konkurruese me negociata, nuk do të diskualifikohet ose përjashtohet nga procedurat e tilla në baza të ndonjë kërkese ose kriteri që nuk është i cekur në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit."

Kontratat dhe referencat tona 100% i përmbushin kërkesën e AK për pune ndërtimore duke u bazuar edhe në kërkesën e juaj për referenca te ngjashme për pune dhe mirëmbajtje AK-ja është e obliguar të pranoj çdo reference për pune me numër 536, 521 dhe 511 dhe për mirëmbajtje me numër 236, 221 dhe 211, të natyrës së ndërtimit të ulët.

Referencat tona te prezantuara ne vlerë 3,379,984.11 € të gjitha bejne pjese ne pune dhe mirëmbajtje të ndërtimit të ulët e që i përgjigjen 100% specifikacionit

të AP në fjalë i cili është shumë më pak kompleks sesa natyra e punëve dhe shërbimeve tona të prezantuara në ofertë.
Dëshmi: Paramasa – specifikacioni teknik i AK-së

Ne kemi ofruar kontrata te natyres se ngjajshme per pune dhe mirembajtje ne tre vitet e fundit si me poshte:

1. Ekzekutimi i punimeve ne K.M. 'Baza e Pare e UÇK-së, Lladoc-Podujevë me nr. Prokurimit: 210-13-098-511
   (deshmia: REFERENC, vlera e kontrates: 1,099,790.04 €)
2. Rregullimi i Varrezave të Dëshmorëve në Dyz, Podujevë – Faza e I-rë me nr. Prokurimit: AMKMK-18-013-521
   (deshmia: REFERENC, vlera e kontrates: 87,855.76 €)
3. Ndërtimi i Kompleksit Memorial "Dëshmorët e UÇK-së) Vrellë – Istog me nr. Prokurimit: AMKMK-16-019-511
   (deshmia: REFERENC, vlera e kontrates: 862,944.48 €)
4. Rregullimi i Varrezave të Dëshmorëve në Dyz, Podujevë – Faza e II-të me nr. Prokurimit: AMKMK-18-035-521
   (deshmia: REFERENC, vlera e kontrates: 29,874.00 €)
5. Vazhdimi i Rivarrimit të Dëshmorëve dhe Punimeve në Vazhdim "Varrezat e Dëshmorë të UÇK-së, Penuhë – Podujevë me nr. prokurimit: AMKMK-18-031-521
   (deshmia: REFERENC, vlera e kontrates: 144,049.01 €)
6. Ndërtimi i objektit të akomodimit për Bat.e I-rë në Kazermen e FSK-së Gjilan me nr. prokurimit: 217-18-2931-5-1-1
   (deshmia: REFERENC, vlera e kontrates: 574,800.01 €)
7. Ndërtimi i objektit me infrastruktur përcjellëse në Njësin Operative Fushë Kosovë dhe Podujevë me nr. prokurimit: Vete Financim 19-7320-5-2-1 PAS 19 054 521
   (deshmia: REFERENC, vlera e kontrates: 338,003.21 €)
8. Ofrimi i shërbimeve të nevojshme në Kompleksin Memorial "Kulla e Zahir Pajazitit" në Orllan, Podujevë me nr. prokurimit: AMKMK-16-004-221
   (deshmia: REFERENC, vlera e kontrates: 124,895.10 €)
9. Mirëmbajtja e K.M. "Baza e Parë e UÇK-së" Lladovc-Podujevë me nr. prokurimit: AMKMK-17-002-221
   (deshmia: REFERENC, vlera e kontrates: 117,772.50 €)

Sa për informim kontratat e cekura me siper jane decidivisht konform kërkeses së AK për punë dhe mirëmbajtje, andaj komisioni i rivleresimit nuk ka bërë vlerësim të drejtë dhe pa drejtësisht na ka eleminuar nga gara.

Sa i përket OE pjesëmarrës në këtë procedure sipas Çmimit me të ulet te ofruar dhe analizës të dokumentacionit të dorëzuar të tenderit nga ana e OE ne kemi vërejtur se komisioni i rivlerësimit pranë AK-se ka bërë shkelje të dispozitave të LPP-se Nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Lgjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092 dhe RRUOPP-së.

Në vijim po ju paraqesim në mënyrë të detajuar faktet dhe argumentet të cilat AK nuk i ka respektuar me rastin e rivlerësimit, krahasimit dhe ekzaminimit të tenderëve.

Faktet dhe argumentet te cilat nuk i ka plotësuar Grup i Operatorëve Ekonomik ARBOR GROUP SH.P.K. ; Pro & Co Group SH.P.K.; SABA BELCA Dega në Kosovë, Rruga Skenderbeu p.n., 62000, Kamenice, Kosovë

1. Është kërkuar:

2.4. Një (1) inxhinier i diplomuar i elektroteknikës - 5 vjet përvojë pune pas diplomimit;

Deshmite te cilat jane kërkuar sipas dosjes se tenderit:

• Kontrata-parakontrata valide e punës për stafin professional – e noterizuar;

OE nuk ka plotesuar kerkesen e AK pasi që kontrata që keni ofruar është e pa nënshkruar nga Inxhinieri në fjale dhe kjo kontratë nuk është valide (e pa kuptueshme se si një kontrat e pa nënshkruar nga pala mund të noterizohet) dhe me këtë rast nuk e plotëson kriterin, po ashtu edhe diploma e noterizuar që keni ofruar nuk e plotëson kushtin pasi që nr. rendor i noterizimit është i njëjtë me nr. rendor të noterizimit të diplomes së Inxhiniert të Hidroteknikës që e keni ofruar në ofertë dhe me këtë rast nuk e plotëson kriterin.

2. Është kërkuar:

2.5. Një (1) inxhinier i diplomuar i gjeologjise - drejtimi hidrogjeologji - 5 vjet përvojë pune pas diplomimit;

Deshmite te cilat jane kërkuar sipas dosjes se tenderit:

• Kontrata-parakontrata valide e punës për stafin professional – e noterizuar;

OE nuk e ka plotesuar kerkesen e AK pasi ka prezantuar inxhinierin e njëjtë që kemi edhe ne si grup i OE-se këtë e keni vertetuar edhe ju si AK pasi ju ka konfirmuar edhe vete Inxhinieri ne fjale qe ka marreveshje per angazhim vetem me kompanin tonë.

3. Është kërkuar:

2.7. Inxhinier i diplomuar i gjeodezisë me 5 vite përvojë pune pas diplomimit, te jete I licencuar.

Deshmite te cilat jane kërkuar sipas dosjes se tenderit:

• Kontrata-parakontrata valide e punës për stafin professional – e noterizuar;

Kontrata – parakontrata valide e punës e noterizuar e cila është kërkuar në (FDT) për Inxhinierin e Gjeodezisë nuk është ofruar e noterizuar sipas kërkesës por vetëm vërtetim nënshkrimi me këtë rast nuk e plotëson kriterin.

4. Është kërkuar:

2.6. Një (1) inxhinier apo bechelor ne menaxhimin e emergjencave minimum 2 vitet pas diplomimit.

Deshmite te cilat jane kërkuar sipas dosjes se tenderit:

• Kontrata-parakontrata valide e punës për stafin professional – e noterizuar;

Kontrata – parakontrata valide e punës e noterizuar e cila është kërkuar në (FDT) për Bachelor në menaxhimin e emergjencave nuk është ofruar e noterizuar sipas kërkesës por vetëm vërtetim nënshkrimi me këtë rast nuk e plotëson kriterin.

5. Është kërkuar:

2.8. - Dy teknik të ndërtimtarisë me se paku 2 vite përvojë pune pas diplomimit në realizimin e projekteve të ngjashme .

Deshmite te cilat jane kërkuar sipas dosjes se tenderit:

• Kontrata-parakontrata valide e punës për stafin professional – e noterizuar;

Diploma kopje e noterizuar e cila është kërkuar në (FDT) për teknik të ndërtimtarisë për njërin teknik të ndërtimtarisë nuk është ofruar kopje e noterizuar sipas kërkesës por vetëm vërtetim kopje nga kopje e çertifikuar me këtë rast nuk e plotëson kriterin.

Kontrata – parakontrata valide e punës e noterizuar e cila është kërkuar në (FDT) për Dy teknik të ndërtimtarisë nuk janë ofruar të noterizuar sipas kërkesës por vetëm vërtetim nënshkrimi me këtë rast nuk e plotëson kriterin.

6. Është kërkuar:

(Licencë – Leje e vlefshme të lëshuar nga KPMM – ja ose Kontratë nga ndonjë ndërmarrje e licensuar nga KPMM–ja (Licencë Leje për bazën e Betonit, Leje për Sortues, Licencë shfrytëzimi për shkëmb të forte).

Deshmite te cilat jane kërkuar sipas dosjes se tenderit:
• Kopja e noterizuar Licences leje per aktivitete te veqanta e vlefshme e lëshuar nga KPMM – ja. Vëmendje! Ne rast se OE nuk posedon licencën, duhet ofruar Marrëveshjen për furnizim me OE te licencuar. Bashkangjitur duhet te jete Licencat e OE. Marreveshja duhet te jete e noterizuar ne mes te qiramarrësi dhe qiradhënësit.
Marrëveshja për furnizim me beton dhe me gurthyes nuk janë ofruar të Noterizuar siq është kërkuar në (FDT) por vetëm vërtetim nënshkrimi dhe me këtë rast nuk e plotëson kriterin.
Sqarim: *Tek ky OE kemi vërejtur që shumica e noterizimeve të diplomave dhe kontratave të stafit kanë nr. rendor të noterizimi të njëjtë në diploma të ndryshme gjë që është e pa kuptim.*

Faktet dhe argumentet te cilat nuk i ka plotësuar Grup i Operatorëve Ekonomik ALFA.i; N.T.SH. Dino Sh.p.k., rr. Ibrahim Rugova pn., 14000, Lipjan, Kosovë

1. Është kërkuar:
2.7. Inxhinier i diplomuar i gjeodezisë me 5 vite përvojë pune pas diplomimit, te jete I licencuar.
Deshmite te cilat jane kërkuar sipas dosjes se tenderit:
• Kontrata-parakontrata valide e punës për stafin professional – e noterizuar;
Diploma e Inxhinierit të diplomuar të gjeodezisë – 5 vjet provoj pune pas diplomimit siq është kërkuar në (FDT) nuk është ofruar sipas kërkesës por keni prezantuar një Diplomë nga Instituti Mbretëror i Teknologjis (KTH Royal Institution of Tecnology) e cila nuk i përket Diplomës së Inxhinierit të Diplomuar të gjeodezisë dhe me këtë rast nuk e plotëson kriterin.

2. Është kërkuar:
1(një) Ngarkues me zingjir të tipit Dozer
Deshmite te cilat jane kërkuar sipas dosjes se tenderit:
• Dokumentacion te pronësisë me dokumente relevante valide kopje ose
Të kontraktuar me marrëveshje origjinale për shfrytëzim të dëshmohen me kontrate
1 (një) Ngarkues me zingjir të tipit Dozer siq është kërkuar në (FDT) nuk keni ofruar dëshmi sipas kërkesës por keni ofruar Eskavator me zingjirë dhe me këtë rast nuk e plotësoni kriterin.

3. Është kërkuar:
2(dy) Kamion special për pastrimin e rrugëve pas ekzekutimit te puneve.
Deshmite te cilat jane kërkuar sipas dosjes se tenderit:
• Libreza e regjistrimit të automjeteve te cilat regjistrohen me afate te regjistrimit-kopje; ose të kontraktuar me marrëveshje origjinale për shfrytëzim të dëshmohen me kontrate
2 (Dy) Kamiona special për pastrimin e rrugëve pas ekzekutimit të puneve me libreza të regjistrimit me afat regjistrimi siq është kërkuar në (FDT) ju keni ofruar Kamiona për pastrim të rrugëve me libreza të regjistrimit pa afat te regjistrimit për njërin Kamion dhe me këtë rast nuk e plotësoni kriterin.

4. Është kërkuar:
5 (Pes) Auto mikser.
Deshmite te cilat jane kërkuar sipas dosjes se tenderit:
• Libreza e regjistrimit të automjeteve te cilat regjistrohen me afate te regjistrimit-kopje; ose të kontraktuar me marrëveshje origjinale për shfrytëzim të dëshmohen me kontrate
5 (pes) Auto mikser me libreza të regjistrimit me afat regjistrimi siq është kërkuar në (FDT) ju keni ofruar vetë 4 auto miksera dhe me këtë rast nuk e plotësoni kriterin.

5. Është kërkuar:

2 (Dy) Papuqe per ngjeshje te kanalit
Deshmite te cilat jane kërkuar sipas dosjes se tenderit:
• Dokumentacion te pronësisë me dokumente relevante valide kopje ose
Të kontraktuar me marrëveshje origjinale për shfrytëzim të dëshmohen me kontrate
Pas analizimit të dokumentit në failin 9. Makineria – PT3.rar në folderi 15. Papuqe për ngjeshje te kanalit te folderi Pllaka vibruese 4copë te dokumenti me emrin (DUD_Pllake ngjeshese 4 cope.pdf) kontrata e bashkangjitur pas dyshimeve nga ana jonë për origjinalitetin e ketij dokumenti e kemi konvertuar kete dokument nga pdf ne word dhe ka rezultu qe nuk eshte origjinal dhe me kete rast OE nuk e ploteson kerkesen per njeren papuqe siq eshte kerkuar.

Faktet dhe argumentet te cilat nuk i ka plotësuar Grupi i Operatorëve Ekonomik NOTI CONSTUCTION SH.P.K. ; N.N.T. Bini, Rr. Cerriku, 10000, Obilic, Kosovë

1. Është kërkuar:
2.2. Udheheqesi i punishtes, duhet të jetë Inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë ose Bahchelor i ndertimtarise - drejtimi konstruktiv.
Deshmite te cilat jane kërkuar sipas dosjes se tenderit:
Diploma përkatëse – Kopje të noterizuar; CV-i ; Kontrata-parakontrata valide e punës për stafin professional – e noterizuar;
Diploma kopje e noterizuar e Inxhinierit të diplomuar të ndërtimtarisë ose Bachelor i ndërtimtarisë drejtimi konstruktivë e cila është kërkuar në (FDT) për Udhëheqësin e punishtes nuk është ofruar kopje e noterizuar sipas kërkesës por vetëm vërtetim kopje nga kopje e çertifikuar dhe me këtë rast nuk e plotëson kriterin.

2. Është kërkuar:
2.3. Një (1) inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë - drejtimi hidroteknik - 7 vjet përvojë pune pas diplomimit;
Deshmite te cilat jane kërkuar sipas dosjes se tenderit:
Diploma përkatëse – Kopje të noterizuar; CV-i ; Kontrata-parakontrata valide e punës për stafin professional – e noterizuar;
Diploma kopje e noterizuar e Inxhinierit të diplomuar të ndërtimtarisë drejtimi Hidroteknik – 7 vjet provoj pune pas diplomimit e cila është kërkuar në (FDT) nuk është ofruar kopje e noterizuar sipas kërkesës por vetëm vërtetim kopje nga kopje e zakonshme dhe me këtë rast nuk e plotëson kriterin.

3. Është kërkuar:
2.4. Një (1) inxhinier i diplomuar i elektroteknikës - 5 vjet përvojë pune pas diplomimit;
Deshmite te cilat jane kërkuar sipas dosjes se tenderit:
Diploma përkatëse – Kopje të noterizuar; CV-i ; Kontrata-parakontrata valide e punës për stafin professional – e noterizuar;
Diploma kopje e noterizuar e Inxhinierit të diplomuar të elektroteknikes – 5 vjet provoj pune pas diplomimit e cila është kërkuar në (FDT) nuk është ofruar kopje e noterizuar sipas kërkesës por vetëm vërtetim kopje nga kopje e zakonshme dhe me këtë rast nuk e plotëson kriterin.
CV-të për stafin profesional – inxhinierët siq është kërkuar në (FDT) ju nuk keni ofruar fare CV për Inxhinier të diplomuar të elektroteknikes – 5 vjet provoj pune pas diplomimit dhe me këtë rast nuk e plotëson kriterin.

4. Është kërkuar:
2.5. Një (1) inxhinier i diplomuar i gjeologjise - drejtimi hidrogjeologji - 5 vjet përvojë pune pas diplomimit;
Deshmite te cilat jane kërkuar sipas dosjes se tenderit:

Diploma përkatëse – Kopje të noterizuar; CV-i ; Kontrata-parakontrata valide e punës për stafin professional – e noterizuar;
Një (1) Inxhinier i diplomuar i gjeologjis – drejtimi hidrogjeologji - 5 vjet provoj pune pas diplomimit të dëshmuar me Diplomë kopje të noterizuar si dhe CV për stafin profesional – inxhinierët siq është është kërkuar në (FDT) ju nuk keni ofruar Inxhinier të gjeologjis të drejtimit Hidrogjeologji sipask kërkesës ndërsa nuk është ofruar kopje e noterizuar sipas kërkesës por vetëm vërtetim kopje nga kopje e zakonshme si dhe nuk keni ofruar fare CV dhe me këtë rast nuk e plotëson kriterin.

5. Është kërkuar:
2.7. Inxhinier i diplomuar i gjeodezisë me 5 vite përvojë pune pas diplomimit, te jete I licencuar.
Deshmite te cilat jane kërkuar sipas dosjes se tenderit:
Diploma përkatëse – Kopje të noterizuar; CV-i ; Kontrata-parakontrata valide e punës për stafin professional – e noterizuar;
Diploma kopje e noterizuar e Inxhinierit të diplomuar të gjeodezis – 5 vjet provoj pune pas diplomimit e cila është kërkuar në (FDT) nuk është ofruar kopje e noterizuar sipas kërkesës por vetëm vërtetim kopje nga kopje e zakonshme dhe me këtë rast nuk e plotëson kriterin.

6. Është kërkuar:
2.8. - Dy teknik të ndërtimtarisë me se paku 2 vite përvojë pune pas diplomimit në realizimin e projekteve të ngjashme .
Deshmite te cilat jane kërkuar sipas dosjes se tenderit:
Diploma përkatëse – Kopje të noterizuar; CV-i ; Kontrata-parakontrata valide e punës për stafin professional – e noterizuar;
Diploma kopje e noterizuar e teknikut të ndërtimtarisë me së paku 2 vite përvoj pune pas diplomimit e cila është kërkuar në (FDT) për njërin teknik të ndërtimtarisë nuk është ofruar kopje e noterizuar sipas kërkesës por vetëm vërtetim kopje nga kopje e zakonshme dhe me këtë rast nuk e plotëson kriterin.

7. Është kërkuar:
1(nje) Ngarkues me zingjir të tipit Dozer
Deshmite te cilat jane kërkuar sipas dosjes se tenderit:
• Dokumentacion te pronësisë me dokumente relevante valide kopje ose
Të kontraktuar me marrëveshje origjinale për shfrytëzim të dëshmohen me kontrate
1 (një) Ngarkues me zingjir të tipit Dozer të dokumentohet me dokumentacion në pronësi ose të kontraktuar me marrëveshje origjinale për shfrytëzim siq është kërkuar në (FDT) nuk keni ofruar asnjë dëshmi sipas kërkesës dhe me këtë rast nuk e plotësoni kriterin.

8. Është kërkuar:
1(një) Eskavator me rrota zinxhirore - 10-12-ton.
Deshmite te cilat jane kërkuar sipas dosjes se tenderit:
• Dokumentacion te pronësisë me dokumente relevante valide kopje ose
Të kontraktuar me marrëveshje origjinale për shfrytëzim të dëshmohen me kontrate
1 (Një) Eskavator me rrota zingjirore – 10-12 ton siq është kërkuar në (FDT) të gjitha dëshmit që keni ofruar nuk e plotësojn specifiken e kërkuar në kërkesë prej 10-12 ton dhe në disa dëshmi tjera nuk i kanë rrotat zingjirore dhe me këtë rast nuk e plotësoni kriterin.

9. Është kërkuar:
2(dy) Kamion special për pastrimin e rrugëve pas ekzekutimit te puneve.
Deshmite te cilat jane kërkuar sipas dosjes se tenderit:
• Libreza e regjistrimit të automjeteve te cilat regjistrohen me afate te regjistrimit-kopje; ose

Të kontraktuar me marrëveshje origjinale për shfrytëzim të dëshmohen me kontrate 2 (Dy) Kamiona special për pastrimin e rrugëve pas ekzekutimit të puneve me libreza të regjistrimit me afat regjistrimi siq është kërkuar në (FDT) ju keni ofruar Kamiona për pastrim të rrugëve me libreza të regjistrimit pa afat te regjistrimit dhe me këtë rast nuk e plotësoni kriterin.

10. Është kërkuar:

1 (një) Kamion (Autobot) e ujit

Deshmite te cilat jane kërkuar sipas dosjes se tenderit:

• Libreza e regjistrimit të automjeteve te cilat regjistrohen me afate te regjistrimit-kopje; ose

Të kontraktuar me marrëveshje origjinale për shfrytëzim të dëshmohen me kontrate 1 (një) Kamion (Autobot) e ujit të dokumentohet me dokumentacion në pronësi ose të kontraktuar me marrëveshje origjinale për shfrytëzim siq është kërkuar në (FDT) nuk keni ofruar asnjë dëshmi sipas kërkesës dhe me këtë rast nuk e plotësoni kriterin.

11. Është kërkuar:

1 (Një) Kamion me kran prej 2-3 ton me peshe bartese

Deshmite te cilat jane kërkuar sipas dosjes se tenderit:

• Libreza e regjistrimit të automjeteve te cilat regjistrohen me afate te regjistrimit-kopje; ose

Të kontraktuar me marrëveshje origjinale për shfrytëzim të dëshmohen me kontrate 1 (Një) Kamion me kran prej 2-3 ton me peshë bartëse siq është kërkuar në (FDT) të gjitha dëshmit që keni ofruar nuk e plotësojn specifiken e kërkuar në kërkesë ku e kalojn peshën bartëse prej 2-3 ton dhe me këtë rast nuk e plotësoni kriterin.

12. Është kërkuar:

2 (Dy) Papuqe per ngjeshje te kanalit

Deshmite te cilat jane kërkuar sipas dosjes se tenderit:

• Dokumentacion te pronësisë me dokumente relevante valide kopje ose

Të kontraktuar me marrëveshje origjinale për shfrytëzim të dëshmohen me kontrate Dy (dy) Papuqe për ngjeshje të kanalit të dokumentohet me dokumentacion në pronësi ose të kontraktuar me marrëveshje origjinale për shfrytëzim siq është kërkuar në (FDT) nuk keni ofruar dëshmi sipas kërkesës, por keni prezantuar vetëm një vibrator për ngjeshje të rruges ndërsa për tjetrën papuqe nuk keni ofruar dëshmi fare dhe me këtë rast nuk e plotësoni kriterin.

13. Është kërkuar:

2(dy) Gjysëm rimorikio apo Kamionet e pajisur me shenja trafiku dhe trupa ndriçuese

Deshmite te cilat jane kërkuar sipas dosjes se tenderit:

• Dokumentacion te pronësisë me dokumente relevante valide kopje ose

Të kontraktuar me marrëveshje origjinale për shfrytëzim të dëshmohen me kontrate Dy (dy) Gjysëm rimorkio apo kamionet e paisur me shenja trafiku dhe trupa ndriques të dokumentohet me dokumentacion në pronësi ose të kontraktuar me marrëveshje origjinale për shfrytëzim siq është kërkuar në (FDT) për njëren gjysëm rimorkio nuk keni ofruar dëshmi të kontraktuar me marrëveshje origjinale për shfrytëzim të këtij mjeti por vetëm librezen e regjistrimit në emër të kompanis RUB SHPK dhe me këtë rast nuk e plotësoni kriterin.

Faktet dhe argumentet te cilat nuk i ka plotësuar Grupi i Operatorëve Ekonomik Arbotec SH.P.K. ; DELTA – CCD SH.P.K. ; AEK MUNELLA SHPK, Bulevardi Bill Klinton nr.76, 10000, PRISHTINË, Kosovë

1. Është kërkuar:

2.2. Udheheqesi i punishtes, duhet të jetë Inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë ose Bahchelor i ndertimtarise - drejtimi konstruktiv.
Deshmite te cilat jane kërkuar sipas dosjes se tenderit:
Diploma përkatëse – Kopje të noterizuar; CV-i ; Kontrata-parakontrata valide e punës për stafin professional – e noterizuar;
Diploma kopje e noterizuar e Inxhinierit të diplomuar të ndërtimtarisë ose Bachelor i ndërtimtarisë drejtimi konstruktivë e cila është kërkuar në (FDT) për Udhëheqësin e punishtes nuk është ofruar kopje e noterizuar sipas kërkesës por vetëm vërtetim kopje nga kopje e çertifikuar dhe me këtë rast nuk e plotëson kriterin.
Kontrata-parakontrata valide e punes për stafin profesional e noterizuar e Inxhinierit të diplomuar të ndërtimtarisë ose Bachelor i ndërtimtarisë drejtimi konstruktivë e cila është kërkuar në (FDT) për Udhëheqësin e punishtes nuk është ofruar kopje e noterizuar sipas kërkesës por vetëm vërtetim nënshkrimi dhe me këtë rast nuk e plotëson kriterin.

2. Është kërkuar:
2.4. Një (1) inxhinier i diplomuar i elektroteknikës - 5 vjet përvojë pune pas diplomimit;
Deshmite te cilat jane kërkuar sipas dosjes se tenderit:
Diploma përkatëse – Kopje të noterizuar; CV-i ; Kontrata-parakontrata valide e punës për stafin professional – e noterizuar;
Diploma kopje e noterizuar e Inxhinierit të diplomuar të elektroteknikes – 5 vjet provoj pune pas diplomimit e cila është kërkuar në (FDT) nuk është ofruar kopje e noterizuar sipas kërkesës por vetëm vërtetim i kopjes së vërtetuar dhe vërtetim i kopjes nga dokumenti i çertifikuar dhe me këtë rast nuk e plotëson kriterin.

3. Është kërkuar:
2.5. Një (1) inxhinier i diplomuar i gjeologjise - drejtimi hidrogjeologji - 5 vjet përvojë pune pas diplomimit;
Deshmite te cilat jane kërkuar sipas dosjes se tenderit:
Diploma përkatëse – Kopje të noterizuar; CV-i ; Kontrata-parakontrata valide e punës për stafin professional – e noterizuar;
Një (1) Inxhinier i diplomuar i gjeologjis – drejtimi hidrogjeologji - 5 vjet provoj pune pas diplomimit të dëshmuar me Diplomë kopje të noterizuar siq është është kërkuar në (FDT) ju nuk keni ofruar Inxhinier të gjeologjis të drejtimit Hidrogjeologji sipask kërkesës ndërsa nuk është ofruar as diploma kopje e noterizuar dhe me këtë rast nuk e plotëson kriterin.

4. Është kërkuar:
2.6. Një (1) inxhinier apo bechelor ne menaxhimin e emergjencave minimum 2 vitet pas diplomimit.
Deshmite te cilat jane kërkuar sipas dosjes se tenderit:
• Kontrata-parakontrata valide e punës për stafin professional – e noterizuar;
Diploma kopje e noterizuar e Inxhinierit apo bachelor ne menaxhimin e emergjencave – 2 vjet provoj pune pas diplomimit e cila është kërkuar në (FDT) nuk është ofruar kopje e noterizuar sipas kërkesës por vetëm vërtetim kopje nga kopje e zakonshme dhe me këtë rast nuk e plotëson kriterin.

5. Është kërkuar:
2.8. - Dy teknik të ndërtimtarisë me se paku 2 vite përvojë pune pas diplomimit në realizimin e projekteve të ngjashme .
Deshmite te cilat jane kërkuar sipas dosjes se tenderit:
Diploma përkatëse – Kopje të noterizuar; CV-i ; Kontrata-parakontrata valide e punës për stafin professional – e noterizuar;
Diplomat kopje e noterizuar e teknikut të ndërtimtarisë me së paku 2 vite përvoj pune pas diplomimit e cila është kërkuar në (FDT) për të dy teknik të ndërtimtarisë

nuk është ofruar kopje e noterizuar sipas kërkesës por vetëm vërtetim kopje nga kopje e zakonshme dhe me këtë rast nuk e plotëson kriterin.

6. Është kërkuar:
1(një) Ngarkues me zingjir të tipit Dozer
Deshmite te cilat jane kërkuar sipas dosjes se tenderit:
• Dokumentacion te pronësisë me dokumente relevante valide kopje ose
Të kontraktuar me marrëveshje origjinale për shfrytëzim të dëshmohen me kontrate
1 (një) Ngarkues me zingjir të tipit Dozer siq është kërkuar në (FDT) nuk keni ofruar dëshmi sipas kërkesës por keni ofruar Bulduzer dhe me këtë rast nuk e plotësoni kriterin.

7. Është kërkuar:
1 (një) Ngarkues (Luge ngarkuese) 0.5-1.0 m3
Deshmite te cilat jane kërkuar sipas dosjes se tenderit:
• Dokumentacion te pronësisë me dokumente relevante valide kopje ose
Të kontraktuar me marrëveshje origjinale për shfrytëzim të dëshmohen me kontrate
1 (një) Ngarkues (Luge ngarkuese) 0.5-1.0 m3 siq është kërkuar në (FDT) dëshmit që keni ofruar është e pa mundur të lexohet për të verifikuar mjetin e specifikuar sipas kërkesës andaj kërkojm që të na dërgoni këtë dokument që dokumentohet qartë

8. Është kërkuar:
2(dy) Kamion special për pastrimin e rrugëve pas ekzekutimit te puneve.
Deshmite te cilat jane kërkuar sipas dosjes se tenderit:
• Libreza e regjistrimit të automjeteve te cilat regjistrohen me afate te regjistrimit-kopje; ose të kontraktuar me marrëveshje origjinale për shfrytëzim të dëshmohen me kontrate
2 (Dy) Kamiona special për pastrimin e rrugëve pas ekzekutimit të puneve me libreza të regjistrimit me afat regjistrimi siq është kërkuar në (FDT) ju keni ofruar Kamiona për pastrim të rrugëve me libreza të regjistrimit pa afat te regjistrimit dhe me këtë rast nuk e plotëson kriterin.

9. Është kërkuar:
1 (Një) Kamion me kran prej 2-3 ton me peshe bartese
Deshmite te cilat jane kërkuar sipas dosjes se tenderit:
• Libreza e regjistrimit të automjeteve te cilat regjistrohen me afate te regjistrimit-kopje; ose të kontraktuar me marrëveshje origjinale për shfrytëzim të dëshmohen me kontrate
1 (Një) Kamion me kran prej 2-3 ton me peshë bartëse siq është kërkuar në (FDT) dëshmit që keni ofruar nuk e plotësojn specifiken e kërkuar në kërkesë ku e kalojn peshën bartëse prej 2-3 ton dhe me këtë rast nuk e plotëson kriterin.

Asnjë nga Operatorët Ekonomik pjesëmarrës nuk ka ofruar asnjë dëshmi mbi kërkesat e lartëcekura duke dështuar të përmbushë këto kërkesa si dhe disa prej dokumenteve të OE është mirë të kërkohen fizikish në origjinal për vërtetësin e tyre se a janë prezantuar siq janë kërkuar nga ana e AK.

Pra, Komisioni i rivlerësimit me rastin e eleminimit tone dhe vlersimit të ofertave të OE si dhe vendimit për anulimin e aktivitetit nuk i ka respektuar dispozitat ligjore përkatësisht nenet:
NENI 7 i LPP-se – Barazia ne trajtim/ Jo – Diskriminimi

NENI 56.3 i LPP-se - Dispozitat e Përgjithshme mbi Përzgjedhjen e Pjesëmarrësve dhe Dhënien e Kontratave
NENI 59 i LPP-se – Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve
NENI 69 i LPP-se – Aftësia teknike dhe/ose profesionale
NENI 65 i LPP-se – Provat shkresore
NENI 41 i Rregullave dhe UOPP-se - Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve.

Nga të gjitha faktet e lartpërmendura kërkojmë nga AK ta aprovoje ankesën tonë si të bazuar dhe lënden ta kthejë në rivlerësim. Pasi që janë të evidentuara shkelje flagrante të dispozitave ligjore të LPP-së, dhe se të njëjtit Operator Ekonomik kanë dështuar që t'i plotësojë kërkesat minimale të dosjes së tenderit.

Pretendimet ankimore të parashtruara në ankesën e deponuar në OSHP, janë të njëjta me pretendimet e kërkesës për rishqyrtim.

FAKTET E RASTIT TË RËNDËSISHME PËR PRETENDIMET – KRITERET PËR VLERËSIM

III.2.1) Kërkesat e përshtatshmërisë:	*Dështmia e kërkuar dokumentare:*
1. Deklaratë nën betim – Operatori ekonomik duhet ti përmbush kërkesat mbi përshtatshmërinë në pajtim me Ligjin mbi ProkuriminPublik në Kosovë, Ligji Nr. 04 L-042 për Prokurimin Publiktë Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04 L-237, ligjin Nr. 05 L-068 dheligjin Nr. 05 L-092 Ligjin Nr. 04 L-042, Neni 65 duke përdorur formën në Aneksin 2. 2. Një vërtetim i nënshkruar nga Administrata Tatimore, se ju nuk keni obligime borxhe te tatimeve në ATK. Vlefshmëria e vërtetimit duhet te jete maksimumi 90 dite nga data e lëshimit deri ne datën e hapjes se ofertave. Vërtetimi kërkohet origjinal ose kopja e vërtetuar, vetëm nga Operatori Ekonomik qe propozohet për shpërblim te kontratës dhe dorëzohet te Autoriteti Kontraktues para publikimit te Njoftimit për Dhënie të Kontratës. 3. Dështmi se kompania (biznesi) nuk është ne falimentim ose nën administrim te dhunshëm gjyqësorë te lëshuar nga Gjykata kompetente. Vërtetimi kërkohet origjinali ose kopja e vërtetuar, vetëm nga Operatori Ekonomik qe propozohet për shpërblim te kontratës dhe dorëzohet te Autoriteti Kontraktues para publikimit te Njoftimit për Dhënie të Kontratës dhe nuk duhet te jete me i vjetër se 180 dite nga data e lëshimit deri ne ditën	*1. Deklarata nën betim – e nënshkruar dhe e vulosur (ky dokument është pjesë e dosjes – Aneksi 2).* *2. Vërtetimi i ATK (i verifikuar ne ëeb faqen e ATK-se).* *3. Vërtetimi nga gjykata kompetente (Origjinal ose kopje e noterizuar nga noteri).* *• Dështimi i Operatorit Ekonomik qe është propozuar qe te shpërblehet me kontrate te sjelle dokumentet te kërkuara ne piken, 2, 3, i jep te drejte Autoritetit Kontraktues qe ofertën ta refuzoj si të papërgjegjshme ta bëjë konfiskimin e sigurimit të tenderit dhe te vazhdoj me shpërblim te kontratës me Operatorin Ekonomik qe është rendit ne vendin e dyte e kështu me radhe.*

e dhënies.	
III.2.2) Përshtatshmëria profesionale: Regjistrimi i operatorit ekonomik në regjistrin professional, komercial dhe ose regjistrin e ndërmarrjeve në vendin e juaj të themelimit. Regjistrimi i TVSH – së.	***Dëshmia e kërkuar dokumentare:*** *Certifikatën e regjistrimit te Biznesit – se bashku me informatat për biznesin, te lëshuar nga Autoritetet e Regjistrimit te Biznesit – Kopje.* *Certifikatën e TVSH – Kopje.*
III.2.3) Kapaciteti ekonomik dhe financiar: Operatori Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi të kënaqshme Autoritetit Kontraktues se qarkullimi vjetor i Operatorit Ekonomik, gjatë tre viteve te fundit (2017, 2018, 2019), në vlerë jo më pak se 1.500.000 €.	***Dëshmia e kërkuar dokumentare:*** *Deklaratat Tatimore vjetore të dorëzuara në ATK për tri vitet e fundit (2017, 2018, 2019).*
III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional: Operatori Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të natyrës së ngjashme për punë dhe mirembajtje, në tri vitet e fundit nga data e publikimit të Njoftimit për Kontratë, në vlerë min. 1,300,000.00 €uro. Numri i punëtorëve të angazhuar në këtë projekt, minimum. 30 punëtor me të dhënat në vijim Emri, mbiemrin, mosha e punëtorit, profesioni, eksperienca (vite) dhe pozicioni në kompani. 2. Operatori Ekonomik duhet te ketë ne listen te paktën këtë staf profesional: 2.1. Menaxheri i Projektit – Inxhinier i Diplomuar Ndërtimtarisë ose master – Drejtimi Konstruktiv, me përvojë pune min. 7 vite pas diplomimit. 2.2. Udheheqesi i punishtes, duhet të jetë Inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë ose Bahchelor i ndertimtarise - drejtimi konstruktiv. 2.3. Një (1) inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë - drejtimi hidroteknik - 7 vjet përvojë pune pas diplomimit; 2.4. Një (1) inxhinier i diplomuar i elektroteknikës - 5 vjet përvojë pune pas diplomimit; 2.5. Një (1) inxhinier i diplomuar i gjeologjise - drejtimi hidrogjeologji - 5 vjet përvojë pune pas diplomimit; 2.6. Një (1) inxhinier apo bechelor ne menaxhimin e emergjencave minimum 2 vitet pas diplomimit. 2.7. Inxhinier i diplomuar i gjeodezisë me 5 vite	***Dëshmia e kërkuar dokumentare:*** *Lista e projekteve te kryera në lëmin e punëve të ngjashme të realizuar në tri vitet e fundit, nga data e publikimit të Njoftimit për Kontratë, duke saktësuar Titujt e projekteve, shumën e kontratës, numrin e Prokurimit, data e kontraktimit – duhet të dorëzohet në origjinal, i nënshkruar dhe i vulosur nga Operatori Ekonomik, DHE dëshmitë e përfundimit, Referencat ose Pranimit teknik për punë të kryera në lëmin e punëve të ngjashme.* *Lista e numrit të punëtorëve të angazhohen pë kryerjen e punëve, minimum. 30 punëtor me t dhënat në vijim Emri, mbiemrin, mosha e punëtorit profesioni, eksperienca (vite) dhe pozicioni n kompani – duhet të dorëzohet në origjinal, nënshkruar dhe i vulosur nga Operatori Ekonomik.* *Dëshmia 2 • Diplomat përkatëse – Kopje të noterizuar; • CV-të për stafin profesional - inxhinieret • Kontrata-parakontrata valide e punës për stafin professional – e noterizuar;* *• Nje deklarate me shkrim per caktimin e menaxherit te projektit – duhet të dorëzohet në origjinal, i nënshkruar dhe i vulosur nga Operatori Ekonomik për pikën* *2.1. • Nje deklarate me shkrim per caktimin e udheheqesit te punishtes – duhet të dorëzohet në origjinal, i nënshkruar dhe i vulosur nga Operatori Ekonomik për pikën* *2.2. • Licenca e Noterizuar e Gjeodetit për pikën 2.7. Lista origjinale e nënshkruar dhe e vulosur nga*

përvojë pune pas diplomimit, te jete I licencuar. 2.8. - Dy teknik të ndërtimtarisë me se paku 2 vite përvojë pune pas diplomimit në realizimin e projekteve të ngjashme . Mjetet, stabilimentet dhe pajisjet teknike që janë të domosdoshme për realizimin e projektit 1(një) Eskavator me rrota zinxhirore - min 20 ton. 4 (katër) Kamion transportues me peshë bartëse mbi 10 m3 1(nje) Ngarkues me zingjir të tipit Dozer 1(një) Bulduzer min 22 ton 1(një) Grejder 12-16 ton 1(një) Eskavator me rrota zinxhirore - 10-12-ton. 1 (një) Ngarkues (Luge ngarkuese) 0.5-1.0 m3 1 (nje) Traktor 4x4 1 (nje) Korpëngrites min 20 metra lartësi 2(dy) Kamion special për pastrimin e rrugëve pas ekzekutimit te puneve. 1 (Një). Cilinder 12 t. 1 (nje) Kamion (Autobot) e ujit 1 (Një) Kamion me kran prej 2-3 ton me peshe bartese 2 (Dy) Auto pompë betoni, 5 (Pes) Auto mikser. 2 (Dy) Papuqe per ngjeshje të kanalit 2 (Dy) vibrator 2(dy) Gjysëm rimorikio apo Kamionet e pajisur me shenja trafiku dhe trupa ndriçuese. Licencë – Leje e vlefshme të lëshuar nga KPMM – ja ose Kontratë nga ndonjë ndërmarrje e licensuar nga KPMM–ja (Licencë Leje për bazën e Betonit, Leje për Sortues, Licencë shfrytëzimi për shkëmb të forte).	*Operatori Ekonomik e pajisjeve – mjeteve te punës në dispozicion për realizimin e punimeve* *• Lista e makinerisë dhe mjeteve të punës qe janë përshkruar te kërkesa te nevojshme për realizimin e punëve te dokumentohen me dokumentacion te pronësisë ose të kontraktuar me marrëveshje origjinale për shfrytëzim të dëshmohen me kontrate - Libreza e regjistrimit të automjeteve të cilat regjistrohen duhet te jete me afate te regjistrimit- kopje; - Për pajisje tjera te dëshmohen me dokumente relevante valide për pajisjet e përshkruara te kapaciteti teknik dhe profesionale – kopje.* *Kopja e noterizuar Licences leje per aktivitete te veqanta e vlefshme e lëshuar nga KPMM – ja. Vëmendje! Ne rast se OE nuk posedon licencën, duhet ofruar Marrëveshjen për furnizim me OE te licencuar. Bashkangjitur duhet te jete Licencat e OE. Marreveshja duhet te jete e noterizuar në mes te qiramarrësi dhe qiradhënësit.*

RAPORTI I KOMISIONIT VLERËSUES

Duke u bazuar në raportin e vlerësimit, komisioni vlerësues ka konstatuar si në vijim:

Komisioni pasi ka analizuar ofertat, duke marr parasysh të gjitha kërkesat e FDT-së, rekomandon të anulohet ky aktivitet i prokumit në munges të OE të përgjegjshëm.

Ky rekomandim i komisionit vlerësues është aprovuar dhe është bërë Njoftimi mbi vendimin e AK-së me 29.10.2020.

Operatori ekonomik ankues "ART-DEA SH.P.K & LONI" SH.P.K, në vlerë totale të ofertës: 777,999.33€.

VENDIMET E MËPARSHME LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

N/A

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

N/A

VLERËSIMI I PRETENDIMEVE TË NDRYSHME TË ANKESËS SË OE "ART-DEA SH.P.K & LONI" SH.P.K – Prishtinë.

Eksperti shqyrtues konstaton se OE ankues "ART-DEA SH.P.K & LONI" SH.P.K, është eleminuar me arsyetimin i cili shihët më poshtë:

arsyeve me vijim:

Oferta e juaj konsiderohet e papërgjegjshme për këto arsye:

- **Oferta e juaj konsiderohet e papërgjegjshme duke çenë se nuk e përmbush kushtin se keni përfunduar me sukses kontrata të natyrës së ngjashme për punë dhe mirëmbajtje, në tri vitet e fundit nga data e publikimit të Njoftimit për Kontratë, në vlerë min. 1,300,000.00 €uro.**

Përgjigje në Pretendimi nr. 1

Opertatori ekonomik ankues "ART-DEA SH.P.K & LONI" SH.P.K, pretendon se janë eleminuar pa të drejtë, ku është konstatuar nga AK-së, se nuk është përmbushur kushti i kërkesës së dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë, nuk keni ofruar kontrata të natyrës së ngjashme për punë dhe mirëmbajtje në tri vitet e fundit nga data e publikimit të Njoftimit për Kontratë në vlerë min 1,300.00.00€, sepse kemi ofruar kontrata dhe referenca në vlerë prej 3,379.984.11€.

Eksperti shqyrtues konstaton se kërkesë e dosjes së tenderit dhe e njoftimit për kontratë është: *"Operatori Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të natyrës së ngjashme për punë dhe mirembajtje, në tri vitet e fundit nga data e publikimit të Njoftimit për Kontratë, në vlerë min. 1,300,000.00 €uro".*

Ndërsa tek Dëshmia dokumentare është kërkuar: *"Lista e projekteve te kryera në lëmin e punëve të ngjashme të realizuar në tri vitet e fundit, nga data e publikimit të Njoftimit për Kontratë, duke saktësuar Titujt e projekteve, shumën e kontratës, numrin e Prokurimit, data e kontraktimit – duhet të dorëzohet në origjinal, i nënshkruar dhe i vulosur nga Operatori Ekonomik, DHE dëshmitë e përfundimit, Referencat ose Pranimit teknik për punë të kryera në lëmin e punëve të ngjashme.".*

Operatori ekonomik ankues "ART-DEA SH.P.K & LONI" SH.P.K, në dosjen e tenderit e ka ofruar listën me 36 projekte në vlerë prej 5,014.623.46€, shihë dëshmin më poshtë dëshminë.

	Totali:	5,014,623.46 €

"ART - EDA" SH.P.K. _____ "LONI" SH.P.K. _____

09.10.2020

Dëshmia e përfundimit te punëve si Referencat ose procesverbalet e pranimit te punëve ose ndonje dokument tjetër që evidentoit punët e natyrës së njejshme.

Attached you will find: Evidence of completion of works such as Refsrences or minutes of acceptance of works or any other document that identifies works of a similar nature.

Në vendimin e dt:06.11.2020, asyeje e eleminimit te refuzimi i kërkesës për rishqyrtim të OE ankues "ART-DEA SH.P.K & LONI" SH.P.K, është cekur:

Nga lista e kontratave për punë të ngjajshme komisioni i vlerësimit ka konstatuar se nuk e përmbushë kërkesën e dosjes së tenderit në shumë prej 1.300.000 Euro. Komisioni duke u bazuar në paramasën e tenderit se punët që do të kryhen në këtë projekt janë kryesisht në kanale të hapura me regjim të ujit, sifone dhe akuadukte nuk i konsideron kontratat e tjera si punë të ngjajshme me natyrën e punëve në këtë projekt.

Operatori ekonomik ankues "ART-DEA SH.P.K & LONI" SH.P.K, me listën e projekteve i ka ofruar dëshmit Referenca dhe pranime teknike të projekteve, të cilat e mbërrinë vlerën *1,300,000.00 €uro, DHE dëshmitë e përfundimit, Referencat ose Pranimit teknik janë në lëmin e punëve të ngjashme, sepse kemi të bëjmë me punë të ngjashme që hynë në lëminë e ndërtimëve të ulëta, dhe nuk di tjetër çfar konsiderohet punë e ngjashme (nuk është kërkuar që dëshmit referencat dhe pranimet teknike të jenë punë të njëjta).*

Pretendimet e OE "ART-DEA SH.P.K & LONI" SH.P.K, pretendon se OE "ARBOR GROUP SH.P.K & Pro & Co Group SH.P.K & SABA BELCA Dega në Kosovë"

Përgjigje në Pretendimi nr. 1

Eksperti shqyrtues konstaton se OE "ART-DEA SH.P.K & LONI" SH.P.K, pretendon se OE "ARBOR GROUP SH.P.K & Pro & Co Group SH.P.K & SABA BELCA Dega në Kosovë", për Inxhinierët e diplomuar të Elektroteknikës, Gjeodezisë, Emergjencave dhe dy Teknikwve tw ndwrtimtarisw, i ka ofruar nënshkrimin e vërtetuar nga noteri dhe nuk janë të noterizuara ashtu siç është kërkuar në dosjen e tenderit.

Gjiathstu pretendon se shumica e këtyre vertetimëve e kanë numrin e njejtë rëndorë, si dhe kontrata e Inxhinierit të Elektros është e pa nëshkruar nga Inxhinieri, dhe shtrohet pyetja se si ka mundur të vertetohet kjo kontratë nga noteri.

Eksperti shqyrtues sqaron se kërkesë e njoftimit për kontratë dhe në dosjen e tenderit tek dëshmit dokumentare është kërkuar: *"Dëshmia 2 • Diplomat përkatëse – Kopje të noterizuar; • CV-të për stafin profesional - inxhinieret • Kontrata-parakontrata valide e punës për stafin professional – e noterizuar".*

Poi ofrojm si dëshmi disa nga format e noerizimëve (vertetimëve):

Republika Srbija
JAVNI BELEŽNIK
Bejzad Iljazi
Preševo
Maršala Tita 53

UOP - II:780-2018
Strana 1 (jedan)

Potvrđuje se da je ova kopija istovetna sa kopiranom ispravom koja je napisana na kompjuterskom štampaču i koja se sastoji od 1 (jednoj) strane/a.----------
Naknada za overu 10 (deset) primerka naplaćena je u ukupnom iznosu od 3.600,00 (tri hiljade šeststo dinara) sa uračunatim PDV-om na osnovu člana 21 tarifnog broja 10 Javnobeležničke tarife.----------

JAVNI BELEŽNIK
Bejzad Iljazi
Preševo
Maršala Tita 53

Za javnog beležnika
Javnobeležnički pripravnik
Florin Kamberi
broj rešenja: IV-6-7072/2017
od 25.09.2017 god.

Republika Srbija
JAVNI BELEŽNIK
Bejzad Iljazi
Preševo
Maršala Tita 53

UOP - II:718-2018
Strana 1 (jedan)

Potvrđuje se da je ova kopija istovetna sa kopiranom ispravom koja je napisana na kompjuterskom štampaču i koja se sastoji od 1 (jednoj) strane/a.----------
Naknada za overu 10 (deset) primerka naplaćena je u ukupnom iznosu od 3.600,00 (tri hiljade šeststo dinara) sa uračunatim PDV-om na osnovu člana 21 tarifnog broja 10 Javnobeležničke tarife.----------

JAVNI BELEŽNIK
Bejzad Iljazi
Preševo
Maršala Tita 53

Za javnog beležnika
Javnobeležnički pripravnik
Florin Kamberi
broj rešenja: IV-6-7072/2017
od 25.09.2017 god.

Republika Srbija
JAVNI BELEŽNIK
Bejzad Iljazi
Preševo
Maršala Tita 53

UOP - II:732-2018
Strana 1 (jedan)

Potvrđuje se da je ova kopija istovetna sa kopiranom ispravom koja je napisana na kompjuterskom štampaču i koja se sastoji od 2 (dve) strane/a.----------
Naknada za overu 10 (deset) primerka naplaćena je u ukupnom iznosu od 3.600,00 (tri hiljade šeststo dinara) sa uračunatim PDV-om na osnovu člana 21 tarifnog broja 10 Javnobeležničke tarife.----------

JAVNI BELEŽNIK
Bejzad Iljazi
Preševo
Maršala Tita 53

Za javnog beležnika
Javnobeležnički pripravnik
Florin Kamberi
broj rešenja: IV-6-7072/2017
od 25.09.2017 god.

Nr.LRP:2543/2019

VËRTETIMI I KOPJES NGA ORIGJINALI

